



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ prot.

Elbasan, më ____ . ____ .2021

LËNDA: Dërgim njoftimi për botim në Buletinin e Prokurimit Publik.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË
SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan

Për: **“Albtelecom” sh.a.** me adrese: Autostrada Tiranë - Durrës, km 7, Kashar, Tiranë.

Procedura e prokurimit: Kërkesë për Propozim – Marrëveshje Kuadër.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Shërbimi i internetit për Bashkinë Elbasan dhe Njësitë Administrative” - Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat **14 muaj**, me fondi limit **7,583,333** (shtatë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre) **lekë pa t.v.sh.**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2021 dhe 2022. Ky fond përbën vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-84123-01-15-2021

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “Vodafone Albania” sh.a. me Nipt: K 11715005 L

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **5,026,000** (pesë milion e njëzet e gjashtë mijë) **lekë** (pa tvsh).

2. “Albanian Satellite Communications” sh.p.k. me Nipt: K 62115018 I

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **6,146,994** (gjashtëmilion e njëqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër) **lekë** (pa tvsh).

3. “Albanian Telecommunications Union” sh.p.k me Nipt: L 01425001 U

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **6,281,800** (gjashtëmilion e dyqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind) **lekë** (pa tvsh).

4. “Albtelecom” sh.a. me Nipt: J 61824053 N

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **4,929,166.2** (katërmilion e nëntëqind e njëzet e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje dy) **lekë** (pa tvsh).

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Ofertuesi “**Vodafone Albania**” sh.a. me Nipt: **K 11715005 L**
2. Ofertuesi “**Albanian Satellite Communications**” sh.p.k. me Nipt: **K 62115018 I**
3. Ofertuesi “**Albanian Telecommunications Union**” sh.p.k. me Nipt: **L 01425001 U**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Ofertuesi “**Vodafone Albania**” sh.a. skualifikohet për arsye se: Operatori ekonomik “**Vodafone Albania**” sh.a. nuk ka paraqitur dokumentacion provues si kontrata te ngjashme, kontrata të mëparshme të lidhura me autoritete të ndryshme, apo ndonjë dokument tjetër që të argumentojë kushtet apo elementët e favorshëm pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Operatori ekonomik ka patur detyrimin ligjor (në referim të nenit 56, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar) që të prezantojë me dokumentacion provues zgjidhjet teknike dhe/ose ndonjë kusht favorizues që do të garantonin realizimin e kontrates pranë autoritetit kontraktor. Nga ana e ofertuesit nuk rezulton të jenë parashtruar të dhëna, fakte apo garanci për origjinalitetin e shërbimit, pasi provueshmeria e këtij kriteri është esenciale duke garantuar autoritetin kontraktor jo vetëm për realizimin e shërbimit por për realizimin e tij sipas standarteve të kërkuara në cilësi dhe volum dhe me çmimin konkurrues të ofertuar. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Autoriteti Kontraktor gjykon se nga ana e operatorit ekonomik “Vodafone” sh.a., oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, nuk janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion i plotë që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i shërbimit të propozuar), duke mos krijuar në këtë mënyrë bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Gjithashtu, Operatori Ekonomik në përgjigje të kërkesës së Autoritetit Kontraktor, Bashkia Elbasan, për ofertën anomalisht të ulët, ka dorëzuar dokumentacion në gjuhë të huaj (anglisht).

Bazuar në seksionin 4 të DST, specifikisht pika 4.6, gjuha e përzgjedhur për hartimin e dokumentave të tenderit është shqipja, prandaj çdo dokumentacion i paraqitur nga OE duhet të jetë në përputhje me gjuhën e zgjedhur, ose në gjuhë të huaj, i përkthyer dhe i noterizuar sipas legjislacionit në fuqi.

Për këto arsye, shpjegimet e ofertës anomalisht të ulët, nuk pranohen nga komisioni i vlerësimit të ofertave dhe operatori ekonomik nuk kualifikohet.

“Në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

Sa mësipër, komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi ta refuzojë ofertën.

2. Ofertuesi “Albanian Satellite Communications” sh.p.k. skualifikohet për arsye se: Operatori Ekonomik “**Albanian Satellite Communications**” sh.p.k. nuk ka paraqitur preventivin siç kërkohet në dokumentat e tenderit, specifikisht në shtojcën nr. 10: "Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit". Për këtë arsye oferta ekonomike konsiderohet e pavlefshme.

“Në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.,

Sa mësipër, komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi ta refuzojë ofertën.

3. Ofertuesi “Albanian Telecommunications Union” sh.p.k. skualifikohet për arsye se: Operatori Ekonomik “**Albanian Satellite Communications**” sh.p.k. nuk ka paraqitur preventivin siç kërkohet në dokumentat e tenderit, specifikisht në shtojcën nr. 10: "Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit". Për këtë arsye oferta ekonomike konsiderohet e pavlefshme.

“Në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.,

Sa mësipër, komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi ta refuzojë ofertën.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. “Albtelecom” sh.a. me Nipt: J 61824053 N

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **4,929,166.2** (katërmilion e nëntëqind e njëzet e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje dy) **lekë** (pa tvsh).

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë **Bashkisë Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve)**, brenda **5 (pesë)** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Ankesa: Ka patur ankesë për dokumentat e tenderit nga operatori ekonomik "Vodafone Albania" sh.a.

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Elbasan, pas shqyrtimit të ankesës ka dalë me vendimin nr. 219/5 prot., datë 28.01.2021, duke mos e pranuar ankesën e paraqitur nga ky operator. Ky vendimin ju komunikua operatorit ekonomik "Vodafone Albania" sh.a. me date 01.02.2021. Operatori ekonomik " Vodafone Albania " sh.a, e dërgoi ankesën për shqyrtim në Komisionin e Prokurimit Publik.

Në datë 26.02.2021, KPP ka dërguar drejt Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Elbasan vendimin nr. 105/2021 prot., për "Modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit", duke ia pranuar ankesën subjektit ankimes. Menjëherë, AK, me anë të një shtojce ka bërë modifikimet përkatëse të dokumentave të tenderit, si dhe ka pritur heqjen e masës së pezullimit të procedurës së prokurimit nga ana e KPP-së.

Me anë të vendimit nr.105/3/2021 prot., KPP ka hequr masën e pezullimit të procedurës. Autoriteti Kontraktor, Bashkia Elbasan, me anë të njoftimit nr. 2019/8 prot., datë 17.03.2021 ka caktuar datën e re të zhvillimit të tenderit e cila ka qenë data 23.03.2021.

Njoftimi i Klasifikimit të Vlerësimit është bërë në datë 16.04.2021.

Autoriteti Kontraktor, ka pritur afatet ligjore për ankesa të vlerësimit nga ana e operatorëve të skualifikuar deri më datë 26.04.2021.

Ankesa për vlerësimin nuk ka patur.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
ZV.KRYETARI
Irland Sina**